# DËSHMI ARKIVI

**A-443504**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | BE: Gjykata Kushtetuese duhet të vendosë për konstituimin e Kuvendit dhe Qeverisë |
| ADRESA | `https://albeu.com/kosove/be-gjykata-kushtetuese-duhet-te-vendose-per-konstituimin-e-kuvendit-dhe-qeverise/1011085/` |
| BURIMI | albeu.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 14 shtator 2026, 14:49:27 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 14 shtator 2026, 14:44:39 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `bfb4f9578ee4790de3d271c1c662cf8cbe23ef853e2dbdf07d97b132a1c9c641` |
| TEKSTI | `51e96269a884588d3972bd01dd702ef42cc680d93303f4e20b626abc22fe5dd0` |
| PAMJA | `479fe0ccdca1f03389e28b2af6d236ccb7ee7f4f7a205b759a067851750925e6` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `b48fcd79433c36101cb1b2213af91c02269e8f1679df691f4e06969384b35069` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `e0b9829abbee6aeaf0cbfff89c7cd5e0dcc89e0fb08f67fff94e9a06c82fe2c5` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/b48fcd79433c36101cb1b2213af91c02269e8f1679df691f4e06969384b35069`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# BE: Gjykata Kushtetuese duhet të vendosë për konstituimin e Kuvendit dhe Qeverisë



Bashkimi Evropian deklaroi se është informuar për votimin e së dielës, përmes të cilit u konstituua Kuvendi i Kosovës dhe u formua Qeveria e re, por nënvizoi se vlerësimi për pajtueshmërinë e këtyre veprimeve me Kushtetutën i takon Gjykatës Kushtetuese.

"Jemi në dijeni të votimeve të së dielës, si dhe vendimeve për konstituimin e Kuvendit dhe formimin e Qeverisë. Gjithashtu, jemi në dijeni edhe për kërkesën e paraqitur në Gjykatën Kushtetuese lidhur me kushtetutshmërinë e këtyre vendimeve. I takon Gjykatës Kushtetuese të shprehet për kërkesën e paraqitur", tha për Radion Evropa e Lirë një zëdhënës i Komisionit Evropian.

Sipas tij, Kosova ka nevojë për institucione "plotësisht të konsoliduara për të çuar përpara reformat dhe për të avancuar në rrugën e integrimit në BE, përfshirë edhe në kuadër të Planit të Rritjes për Ballkanin Perëndimor".

Gjatë seancës konstituive të së dielës, më 13 shtator, Kuvendi zgjodhi nënkryetarët nga Lidhja Demokratike e Kosovës, komuniteti serb dhe pakicat joserbe. Kryetarja e Kuvendit, Albulena Haxhiu, e shpalli të përfunduar konstituimin e organit ligjvënës, ndonëse nuk ishte zgjedhur nënkryetari që i takon Partisë Demokratike të Kosovës, forcës së dytë politike në vend.

Disa orë pas kësaj, deputetët zhvilluan një seancë të jashtëzakonshme ku miratuan Qeverinë e re të Kosovës, të drejtuar nga Albin Kurti. Në këtë mbledhje nuk morën pjesë PDK-ja, LDK-ja dhe Aleanca, ndërsa të pranishëm ishin vetëm deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje të Kurtit dhe përfaqësuesit e komuniteteve joshumicë.

PDK-ja, e cila mungoi në seancën konstituive, e kishte tërhequr më herët kandidaturën e Vlora Çitakut për postin e nënkryetares së Kuvendit, pasi LVV-ja nuk e kishte mbështetur atë në seancën e 11 shtatorit. Më vonë, LVV-ja deklaroi se do ta votonte Çitakun, por PDK-ja nuk u paraqit në seancë.

Në 11 shtator ishte zgjedhur edhe nënkryetari i Kuvendit nga radhët e LVV-së, ndërsa Albulena Haxhiu ishte

të fundit/


Shtypja shtetërore në Rusi zgjerohet, qindra të mitur përballen me…


Berlini do të dërgojë deri në 1,000 trupa në Lituani, NATO forcon…


21 viktima nga përplasja e dy minibusëve në Afrikë…


Ndahet nga jeta babai i Andy Burnham pas betejës me Alzheimer…


Dhimbje e madhe për Genta Ismajlin, këngëtarja humb një…


Rrëfimi tronditës i infermieres shtatzënë: humbi foshnjën gjatë…


Mickoski: Ulja e çmimeve të karburantit u ka kursyer qytetarë…

Aleanca për Media Etike ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

votuar në krye të Kuvendit gjatë seancës së mëparshme, të zhvilluar më 9 shtator.

Pas këtyre zhvillimeve, PDK-ja iu drejtua Gjykatës Kushtetuese duke kërkuar vendosjen e një mase të përkohshme ndaj Kuvendit të ri. Partia kërkoi që masa të qëndrojë në fuqi deri në shqyrtimin e përputhshmërisë së procesit të konstituimit me Kushtetutën.

Komisioni Evropian konfirmoi gjithashtu se BE-ja është në dijeni të kësaj kërkese dhe përsëriti se vendimi për të i takon Gjykatës Kushtetuese.

Ankesa u dorëzua të hënën në mëngjes nga deputetët e PDK-së, Arian Tahiri dhe Përparim Gruda, së bashku me avokatin Faton Fetahu, në emër të kësaj partie.

Pas paraqitjes së kërkesës, Tahiri u shpreh para mediave se fillimisht duhet të miratohet një masë e përkohshme, "në mënyrë që të mos shkaktohen dëme e situata më të rënda në kuptim juridik dhe institucional".

Përfaqësuesit e PDK-së pretendojnë se Lëvizja Vetëvendosje, e cila është në pushtet, ka shkelur afatin kushtetues prej 30 ditësh për konstituimin e Kuvendit, si dhe rregullin që parashikon thirrjen e seancës çdo 48 orë deri në përfundimin e këtij procesi.

Në bazë të një aktgjykimi të Gjykatës Kushtetuese të vitit të kaluar, Kuvendi duhet të konstituohet brenda 30 ditësh nga certifikimi i rezultateve. Ky afat skadoi më 7 gusht 2026. /REL

Shtuar më 14.09.2026 16:44

Tags: Be , Kushtetuesja , kuvendi , Qeveria


Lista Serbe kërkon forcimin e misioneve të KFOR-it dhe EULEX-it para vendimit t…


Reuters: Aktgjykimi ndaj Thaçit në Hagë, një ngjarje tektonike për Kosovën dh…


Haga pret vendimin për ish-krerët e UÇK-së, në seancë zyrtarë, familjarë e…



IPK kërkon pezullimin e policit të dyshuar për përvetësimin e 105 eurov…


Rutte: KFOR-i do të qëndrojë në Kosovë pavarësisht zhvillimeve t…


Kontrolle të shtuara në dyqanet e tekstilit për çmimet, promocionet dhe…


Policia e Kosovës rrit gatishmërinë për 16 shtatorin, mund të ketë…



Transporti ajror në Kosovë rritet, ndërsa ai hekurudhor shënon rënie

© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko… Kërko

**Kryesore**
Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

**Kategori**
Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

**Linqet**
Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

**Tags**
Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

**Moti**
Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!
Kontaktoni | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.